

MEMORANDUM BASHKEPUNIMI

MIDIS ISKSH dhe UMSH

Nr. Prot. 2446
19.2.201

Nr.Prot. 106
19.2.2011

Neni 1

Urdheri i Mjekeve te Shqiperise (ne vazhdim UMSH) dhe Instituti I Sigurimeve te Kujdesit Shendetesore (ne vazhdim ISKSH), ne baze dhe per zbatim te Ligjit nr. 8615, date 01.06.2000 "Per Urdherin e Mjekeve ne Republiken e Shqiperise" . Ligjit Nr, 7870, date 13.10.1994 "Per Sigurimet Shendetesore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar dhe Ligji Nr.10107, date 30.03.2009 "Per Kujdesin Shendetesor ne Republiken e Shqiperise", dhe Ligjit Nr. 10171 "Per Profesionet e Rregulluara ne Republiken e Shqiperise" shprehin vullnetin dhe mirekuptimin e institucionalizuar bashkepunimin e qendrueshem sipas fushave perkatese, ne nivel qendrore e lokal, duke e konsideruar te domosdoshme kete bashkepunim per rritjen dhe permiresimen e standarteve dhe cilesise se kujdesit Shendetesore.

Neni 2

Per te siguruar nje sherbim dhe kujdes shendetesor sa me cilesor ISKSH dhe UMSH e konsiderojne te domosdoshem rritjen dhe permiresimin e vashdueshem te kompetences dhe performances profesionale te mjekeve nepermjet formave te Edukimit te Vazhdueshem Mjekesore dhe zhvillimit profesional. Te dy institucionet bien dakort te bashkepunojne per te nxitur dhe mbeshtetur keto procese dhe zhvillimin e tyre ne perputhje me nevojat dhe kerkesat profesionale te mjekeve, dhe do te terhiqen ne bashkepunim, duke i aktivizuar per kete qellim edhe shoqatat shkencore te mjekeve.

Neni 3

Te dy institucionet bien dakort dhe angazhohen per te gjetur dhe aplikuar format me te pershtatshme per Edukimin e Vazhdueshem Mjekesor, si edhe per te lehtesuar e mundesuar pjesemarrjen sa me te gjere te mjekeve ne keto forma.

Neni 4

ISKSH dhe UMSH bien dakort te bashkepunojne per ushtrimin e kontrolleve sistematike ndaj institucioneve Shendetesore ne drejtim te respektimit dhe zbatimit te standarteve te ushtrimit profesional ne perputhje me principet e Kodit te Etikes dhe Deontologjise Mjekesore, Udhzuesit Klinik dhe protokollat e mjekimit.

Neni 5

Te dy institucionet, ISKSH dhe UMSH e konsiderojne prioritet te punes se tyre luften antikorrupsion dhe marrin persiper mbeshtetjen e ndersjellte per organizimin e kontrolleve te perbashketa, parandalimin dhe ndeshkimin e ketij fenomeni ne institucionet shendetesore dhe ne rradhet e profesionisteve te shendetit.

Neni 6

Kur ne kontrollet e ushtruara, ISKSH dhe strukturat vartese konstatojne shkelje nga mjeket gjate ushtrimit te profesionit, te papajtueshme me principet e Kodit te Etikes dhe Deontologjise Mjekesore, marrin persiper t'i relatojne ato ne Urdherin e Mjekeve. UMSH ne perputhje me dispozitat e Kodit te Etikes dhe Deontologjise Mjekesore, si dhe aktet e tjera normative qe mbeshtesin veprimtarine e tij, do te shqyrtoje dhe ndeshkoje keto raste ne vartesi te kundervajtjes se konsumuar deri ne heqjen e Licenses se ushtrimit te profesionit.

Neni 7

Ne mbeshtetje te Ligjit nr.8615, dt.01.06.2000 "Per Urdherin e Mjekeve ne Republiken e Shqiperise", te Ligjit nr.10107, dt.30.03.2009 "Per kujdesin shendetesor ne Republiken e Shqiperise", te Ligjit nr. 10171, dt.22.10.2009 "Per profesionet e rregulluara ne Republiken e Shqiperise", asnje individ nuk mund te ushtroje profesionin e mjekut ne Republiken e Shqiperise pa qene anetar i UMSH dhe i pajisur me Licensen per ushtrimin individual te profesionit nga ky organizem.

ISKSH me strukturat qe ka ne varesi do te kontrolloje zbatimin e kesaj dispozite ne institucionet shendetesore te kontraktuara prej tij dhe nuk do te lejoje te punesohen ne keto institucione, mjeke te cilet nuk jane te pajisur me Licensen e leshuar nga UMSH.

Neni 8

Ne baze te ligjit "Per profesionet e rregulluara ne Republikene e Shqiperise ", per te fituar te drejten e ushtrimit te profesionit, cdo mjek past te jete diplomuar, duhet te kryeje praktiken profesionale dhe provimin e shtetit. UMSH kryen rregjistrimin provizor dhe pajis praktikantet me dokumentacionin e nevojshem, si dhe merr persiper organizimin dhe mbarevajtjen e kesaj praktike ne te gjitha institucionet shendetesore te sherbimit paresor e dytesor te vendit, te miratuara nga Ministri i Shendetesise per kete qellim.

ISKSH dhe strukturat e tij vartese, do te mbeshtesin UMSH per te organizuar dhe mundesuar kryerjen e praktikës profesionale ne keto institucione ne kushte optimale dhe me mundesi maksimale perfitimi.

ISKSH gjithashtu do te angazhohet te perzgjedhe dhe t,i rekomandoje Urdhrit, mjeket me me pervoje qe plotesojne kushtet per ti udhehequr dhe mbikqyrur praktikantet dhe te premtojne kryerjen e praktikës ne perputhje me kerkesat e Rregullores.



Neni9

ISKSH-ja dhe Urdheri i Mjekeve man-in angazhimin e perbashket per te transmetuar frymen e mirekuptimit dhe te bashkepunimit qe mbart nenshkrimi e ketij Memorandumi ne te gjitha strukturat e tyre qendrore dhe **lokale**.

Per UMSH

Dr.DIN ABAZAJ ,



President



Per ISKSH

Elvana HANA

Drejtoresh e Përgjithshme



This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.